



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BELSH
KESHILLI BASHKIAK BELSH**

Belsh më 27/ 01/ 2026

PROCES – VERBAL

“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 27.01.2026”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

➤ **Janë prezent në mbledhje 15 këshilltarë:**

1. Erjon Qafa
2. Bujar Blloku
3. Avni Shtylla
4. Nexhip Elezi
5. Dorina Meta
6. Sami Uruçi
7. Gazeli Hysa
8. Fadil Zdrava
9. Kujtim Dervishi
10. Asqeri Kuqja
11. Erion Gjoshi
12. Ismail Paja
13. Gezim Gjoshi
14. Enkeleda Kullolli
15. Aurjola Bezati

- Kryetari i këshillit hap mbledhjen. Hidhet në votim rendi ditës dhe miratohet me 13 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.1 e rendit të ditës për kriteret e 6%. Prezanton Entela Dervishi.
- B.Blloku: A ka përgjegjësi punonjësi për përzgjedhjen e aplikantëve?
- E.Dervishi: Po, është përgjegjësia e punonjësit.
- Kujtim Dervishi: Para 6 muajsh është krijuar një komision për verifikimin e 6%. Presim Konkluzionet.
- Hidhet në votim pika nr.1 dhe miratohet me 14 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.2 e rendit të ditës. Hidhet në votim 6% dhe miratohet me 14 vota pro.
- Diskutohet pika nr.3 e rendit të ditës për miratimin e dëmëve për rënien e zjarrit në shtëpinë e Hyqmet Çarçiu. Hidhet në votim dhe nuk miratohet me 10 vota pro dhe 4 vota kundër.
- Hidhet në votim pika nr.4 dhe nuk miratohet me 10 vota pro, 2 kundër dhe 2 abstenim.

- Kalojmë te pika nr.5 e rendit të ditës “Për miratimin e listës së aplikantëve për bonusin e qirasë,për vitin 2026”.
- I.Paja: Pse është ulur numri i familjeve?
- E.Leka: Nga 59 familje ,kemi 54 familje që do të subvencionohen.
- E.Gjoshi: A ka ndonjë projekt Bashkia për banesa sociale?
- E.Leka: Jo,nuk ka ndonjë projekt për momentin për banesa sociale.
- D.Meta: Të marrin subvencione ato familje që kanë vërtet nevojë.
- Hidhet në votim pika nr.5 dhe miratohet me 11 vota pro dhe 3 vota abstenim.
- Kalojmë te pika nr.6,hidhet në votim dhe miratohet me 12 vota pro dhe 2 vota abstenim.
- Kalojmë te pika nr.7 e rendit të ditës për hapjen e rrugës paralel me kanalin e furnizimit në liqenin e Belshit. Prezanton P/Vendimin Anxhelina Liçi.
- Erion Gjoshi: A ka banesa në këtë vijë të pronës shtet që do hapet?
- Anxhela Dervishi:Kemi kërkuar dokumentet e pronësisë nga banorët. Gjatë viteve janë legalizuar objektet dhe jo toka.Ndërtesa nuk ka nga matjet që janë bërë dhe banesat nuk preken nga kjo hapje rruge.
- K.Dervishi: Domethënë nuk ka objekte?
- A.Dervishi: Jo,nuk ka objekte që preken.
- Asqeri Kuqja: Po në krahun sipër a ka objekte që pengojnë?
- A.Dervishi: Kanali është vendosur në pjesën poshtë.
- A.Kuqja:Hapja e kanalit do të ishte rrezik. Duhet hapur vëndi i shakrkimit dhe kanali transmetimit.Hapja nuk është zgjidhje.
- Sami Uruçi: Na sillni një projekt se si do menaxhohet dhe se si do hapet.
- A.Dervishi: Pllakat e kanalit janë në disa vënde të hapura duke krijuar bllokim të kanalit.
- Ismail Paja: Unë jam për hapjen e kanalit dhe për hapjen e rrugës.
- E.Gjoshi: Nuk jemi të qartë në lidhje me këtë projekt.
- K.Dervishi:Kërkojmë një projekt të detajuar në mbledhjen e ardhshme.Duhet të vijnë inxhinierët dhe ta shpjegojnë.
- Hidhet në votim hapja e rrugës dhe miratohet me 13 vota pro Ndërsa për hapjen e kanalit kërkohen informacione më të detajuara nga inxhinierët e Bashkisë bashkë me projektin e detajuar.Abstencion E.Qafa.
- Kalojmë te të ndryshmet. Diskutohet kërkesa për ndihmë financiare për z.Ferdinant Zdrava. Hidhet në votim dhe nuk miratohet me 14 vota kundër.
- Diskutohet pika nr.2 e të ndryshmeve për hapje rruge në fshatin Gradishtë. Kjo kërkesë i kalohet zyrës përkatëse.

Mbyllet mbledhja me 5 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA



+